



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

OPINION

MBI

KANDIDATIN QË KA APLIKUAR PËR T'U KOMANDUAR SI PEDAGOG I BRENDSHËM, NË DEPARTAMENTIN E FORMIMIT FILLESTAR, TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 264 dhe 265 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53 e 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, me Vendimin nr.133, datë 09.07.2019, shpalli rihapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Vendimi si më lart i Këshillit të Lartë Gjyqësor, është shpallur në faqen zyrtare të internetit më datë **10.07.2019**, ndërsa afati i paraqitjes së kërkesave për komandim në vendin vakant është përcaktuar 3 (tre) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, afat ky që përfundonte më datë **31.07.2019**.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, **pra brenda datës 31.07.2019**, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka paraqitur kërkesë z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Në respektim të përcaktimit të bërë në pikën 4, të nenit 54, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me vlerësimin e Këshillit, nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës çmon se, në rastin konkret, komandimi i këtij gjyqtari vjen ndesh me interesat e larta të gjykatës ku ai ushtron funksionin.

Në dhënien e këtij vlerësimi, Komisioni konsideron faktin që Gjykata e Apelit Shkodër, në organikën e saj, ka 10 gjyqtarë dhe aktualisht funksionin e gjyqtarit e ushtrojnë 8 gjyqtarë, për shkak se gjyqtarët {...} dhe {...}, në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Gjithashtu Këshilli vlerëson dhe ngarkesën e kësaj gjykate, nga ku rezulton se aktualisht Gjykata e Apelit Shkodër ka në gjykim 1391 çështje dhe mesatarja e çështjeve në gjykim për gjyqtar rezulton të jetë 173.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar se:

- *Gjykata e Apelit Shkodër nuk funksionon me organikë të plotë, pasi funksionin e gjyqtarit në këtë gjykatë aktualisht e ushtrojnë 8 gjyqtarë;*
- *Faktin që gjyqtarët e kësaj gjykate janë në proces rivlerësimi, rezultatet e të cilit nuk mund të parashikohen;*
- *Faktin që ngarkesa e kësaj gjykate rezulton të jetë e lartë. Nga të dhënat e cituara më sipër rezulton që gjyqtarët e kësaj gjykate kanë në gjykim një mesatare çështjesh prej 173 çështje për gjyqtarë, duke përfshirë këtu vetëm çështjet ku ata janë caktuar si relatorë;*
- *Faktin që gjykata e apelit gjykon me trup gjykues me 3 gjyqtarë dhe largimi i një gjyqtari nga trupi gjykues cenon funksionimin dhe mbarëvajtjen normale të gjithë gjykatës;*

vlerëson se, komandimi i z. {...}, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës, cenon interesat e larta të kësaj gjykate për shkak se cenohet funksionaliteti i saj, bazuar në shkaqet e cituara në këtë relacion.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Përfshirjen e z. {...} nga procedurat e komandimit, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS